

**STATUT**  
**I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"FARMACI 24 SHKODER" SH.P.K**

Në këtë statut :

- "Ligji "është Ligji Nr . 9901 ,dt 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"
- "Statuti " Është Statuti i Shoqërisë.

**Kreu I**

**Themelimi ,Emri ,Objketi ,Kohëzgjatja ,Selia**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " FARMACI 24 SHKODER " sh.p.k. themelohet në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë shoqëri.

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me datë 22/ Mars/ 2021, Ne ,Themeluesit ,Ditmir Saiti ,kam krijuar një Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar me emrin "Farmaci 24 SHKODER" SH.P.K.

**Themeluesi e Shoqerise Jane Ortaket :**

1. **Ditmir Saiti** i Biri i Hadis lindur me 10 /Korrik /1989 , lindur dhe banuese në Shkodër,  
Rruga,Kongresi i Permetit

**Neni2**

**Objekti**

**Shoqeria do të kryeje aktivitetin e poshte - shenuar :**

Farmaci ,

**Neni3**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqërise FARMACI 24 SHKODER Sh.P.K do te jete për një periudhe të papërcaktuar.

**Neni4**

**Adresa e Shoqërisë**

Selia e Shoqerise ndodhet në adresen : Rr Kole Heqimi ,Zona Kadastrale 8592 , Nr Pasurie Nr 9/485+1-2 dhe 9/485+1-1 Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon finance-z@hotmail.com

Kreu II  
Kapitali i Regjistruar

Neni 5  
Kapitali Themeltar

**1. Kapitali themeltar ,fillestarë I shoqerise "FARMACI 24 SHKODER " SH.P.K eshte 10,000,000.00 (Dhjete million ) Leke.**

Pjesemarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërise është në perputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1.Ortaku themelues Ditmir Saiti : Zotërues i **1 (një )kuote** me vlerë të përgjithshme **10,000,000 lekë** , që përbejnë **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni6  
Zmadhimi dhe Zvoglimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyre ,nëpërmjët emerimit nga gjykata kompetente e një Eksperti të autorizuar ,për këto contribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak ,për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvoglimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve , e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohet për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvoglimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjesave të kapitalit qe përfaqësojnë .

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a ) kontributit në kapitalin e shoqërisë ;
- b) shit-blerjes;
- c) trashëgimisë ;
- ç) dhurimit ;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj .

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve ,për sa nuk parashikohe ndryshe në statut.

### Kreu III

#### ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

###### Organ ë Vendim-marrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organ i vetëm vendim-marrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendim-marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë per çështjet e mëposhtme :

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likujdusve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- dh)Percaktimin e shpërblimeve per pësonat e përmendur në shkronjën ( c ) dhe ( ç ) të kësaj pike.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise së veprimtarise .
- f) Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit te shoqërisë.
- g) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- h) Përfaqësimin e shoqerise në gjykatë dhe në procedimet e tjera të administratoreve .
- i) Riorganizimin dhe Prishjen e shoqerise.
- j) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të Asamblesë.
- k) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji dhe statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme ,në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i oetakëve në asamblenë ë përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme ,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### Neni 9

###### Thirrja e Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike.Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik

duhet te permboje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij nenii, ajo mund te mane vendime te vlefshme veteran nese te gjithe ortaket jane dakord, per te mane vendime, pavaresisht parregullsise.

#### Neni 10

#### KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve ,që kerkojnë një shumice të zakonshme ,asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nese marrin pjese ortakët me të drejtë vote ,që zoterojnë më shumë se 30 5 të kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje ,të cilat kerkojnë shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te Ligjit “ Per Tregtarët dhe shoqërите Tregtare ” ajo mund te marrë vendime të vlefshme vetëm,nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive,janë të pranishëm përsosur ,votojnë me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 të nenit 88 të ketij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund te mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur më lart ,asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë ,me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

#### Marrja e Vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me % e votive te zotéruesve të kapitalit ,të ortakëve pjesmarrës,për ndryshimin e statutit ,Zmadhimin ose Zvoglimin e Kapitalit të rregjistruar,shpërndarjen e fitimeve ,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicen e votive te ortakëve pjesëmarrës ,për çeshtje te tjera si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë
- b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorëve
- c) Emerimin dhe shkarkimin e Likujdusve dhe te Ekspertëve kontabel te Autorizuar
- d) Percaktimin e Shpërblimeve
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoret ,perfshire preqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurise së veprimtarise se Shoqërisë
- f) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve te asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e Shoqërisë.

#### Neni 12

#### Votat e Ortakeve

(1) Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, cdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishern apo pertaesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte

person juridik) i cili eshte i pranishem permes perfaquesuesit ligjor apo perfaquesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

(2) Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblee se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaquesuesve, ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.

(3) Cdo kundershtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar, Te gjitha votat e pakundershtuara ne nje mbledhje ose mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

### **Neni 13**

#### **Përjashtimi nga e drejta e Votës**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejtë e votës nëse asambleja e pergjithshme merr vendim për :
  - a) Vlerësimin e Veprimitarisë se tij;
  - b) Shuarjen endonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria ;
  - d) Dhenien ose jot ë perfitimeve te reja ;
2. Kur ortaku përfaqësohet nga nje përfaqesues i autorizuar ,i autorizuari vlerësohet te jetë në të njëjtin konflikt interes ,ashtu si dhe ortaku ,të cilin përfaqeson.

### **Neni 14**

#### **Emerimi i Administratoreve**

1. Asambleja e Pergjithshme zgjedh nje ose disa persona fizike si Administrator te shoqerise per nje periudhe pesevjecare, ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te nenit 81 dhe nenit 95 te Ligjit. Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjirhshme, i cili, nese miratohet, sjell ernerimin e personit te propozuar si Administrator.
2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme,sipas përcaktimit te nenit 207 te këtij ligjhi ,nuk mund te emërohen si administrator te një shoqërie te kontrolluar dhe anasjelltas.Çdo emerim i bërë ne kundershtim me këto dispozita është i pa vlefshem.
3. Kufizimet ne lidhje me emerimin e Administratoreve parashikohen ne pikën 2 te nenit 95 te Ligjit.
4. Personi i me poshtem caktohet si **Administrator i shoqerise**.

Te dhenat e identifikimit: (Emri , Mbiemri dhe adresat ):


Ditmir Saiti , i biri i Hadis , i lindur më 11/07/1989 ne Shkoder me Nr ID 190711111 W dhe

Nr Leternjoftimi 034828022

Adresa: Rruga, Kongersi i Permetit.

Dhe specimentet e nenshkrimit:

**Nenshkrimi ( Specimeni )**



**Neni 15**  
**Kompetencat e Administratoreve**

Administratorët kane të drejtë e detyrohen të :

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit të veprimtarise tregtare të shoqerise ,duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e per gjithshme ;
- b) Te perfaqësojë shoqërinë tregtare ;
- c) Kujdeset per mbajtjen sakte e te rregullit të dokumentave dhe të librave kontabël te shoqërise;
- d) Përgatisin dhe nënshkruajne bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe së bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve ,I paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim ;
- e) Të kryej detyra të percaktuara ne ligj dhe ne statut ;
- f) **Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:**
  - 1. Personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit;
  - 2. Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
  - 3. Personi vuau ose mund te vuaje nga çrrregullime mendore;
- g) Personi jep doreheqjen nga detyra duke njofuar shoqerine, ose ka munguar ,per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos ta Shkarkoje nga detyra.

Asambleja e e per gjithshme mund të shkarkoje administratorin në cdo kohe me shumice të zakonshme.Padite ,qe lidhen me shpërbimin e administratorit ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine ,rrregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Neni 16**  
**Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme**

- (1) Asambleja e Pergjithshme merr vendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorumi te parashikuar nga nen 86 i Ligjit. Ortaket ose perfaquesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (conference call) audio ose audio-video, ne perputhje me nenin 88 te Ligjit. Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne neperrnjet numrit PIN qe iu eshte derguar se bashku me njofimin per mbledhjen e Asamblese se Pergjirhshme.
- (2) Administratoret caktojne Kryetarin e mbledhjes si edhe një person per te mbajtur procesverbalin e saj.
- (3) Nese asnjë prej Administratoreve nuk deshiron te caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nese asnjë prej Administratoreve nuk eshte i pranishern per pesembedhjete minuta duke filluar nga ora e caktuar per fillimin e mbledhjes, ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si Kryetar te mbledhjes.

(4) Adrninistratori, pavaresisht se nuk eshte ortak, ka te drejten e pjesernarrjes si edhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme.

(5) Kryetari, me pelqimin e Asamblese se Pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligi, mund (dhe eshte i detyruar nese kerkohet nga Asambleja e Pergjithshme), te shtye mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e meparshme. Kur mbledhja e Asamblese se Pergjithshme shtyhet te pakten katermbedhjete dite, njoftimi do te kryhet te pakten shtate Dite te Plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet ora dhe vendi i mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi i pergjithshem i rendit te dites. Ne rast te kundert, dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:

Kryetari; ose

1.nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit therneltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaqesues i autorizuar i ortakut ka te njejten vlore me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku,

### Neni 17

#### Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

1. Adrninistratoret shperblehen ne baze te skernes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenin 97 te Ligjit.

2. Asambleja e Pergjithshme mund te parashikoje perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesar ne Shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/ en, Ish- bashkeshortin/ en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribuite ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.

3. Administratoreve mund t'iu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarjen e ryre ne mbledhjet e Administratoreve ose te komiteteve te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me perm bushjen e detyrave te tyre.

### Neni 18

#### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte perjegjes individualisht perjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve ,per shkelje te ligjeve ,per shkelje te statutit ,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise ,I ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen ,per te perballuar ne menyr e individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshtet parashikuar ne dispozitat e perjishme te detyrimit te besnikerise ,sipas neneve 14 ,15, 17

e 18 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërите Tregtare ", administrator detyrohet :

1. a) Te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqërise në tërësi ,duke l kushtuar vëmendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise në mjedis ;  
b) Të parandaloje dhe të menjanoste rastet e konfliktit , present apo te mundshem ,të interesave personale me ato te shoqërise ;  
c)të ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem .
2. Administratori ,gjate kryerjes se detyres per gjigjet ndaj shoqerise ,për cdo veprim ose mosveprim ,që lidhet ne mënyre të arsyeshme me qëllimet e shoqërise tregtare ,me përjashtim te rasteve kur , në baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

#### Kreu IV

#### **Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**

##### **Neni 19 Dividendet**

(1) Pas plotesimit te parashikimeve te nenit 77 te Ligiit, shoqeria me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese se Pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

(2) Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat, te gjithe dividendet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me shumat e paguara per kuotat per te cilat paguhet dividendi. Te gjithe dividendet pjesetohen dhe paguhen ne perpjasetim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjeses ose pjesave te periudhes per te cilin paguhet dividendi; ne rast se kuota ernetohet me kushtin e pertitimit te dividendit nga nje date e caktuar, dividendi do te paguhet ne perputhje me kete kusht,

(3) Asnjë dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohe: nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

(4) Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet brenda dymbedhjete vjetoreve nga data e maturimit, ne rast se vendoset me shumice te kualifikuar votash nga Asambleja e Pergjithshme, do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete me e detyruar qe ta paguaje ate.

##### **Neni 20**

##### **Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar**

Administratoret, pas vendimit te marre nga Asambleja e Pergjithshme me shumice te kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e percaktuara ne nenin 14 te Ligjit, mund te vodosin te kalojne ne kapitalin themeltar te shoqerise fitimet e pashperndara te cilat nuk do te perdoren per te paguar dividende preferenciale apo shuma te tjera te parashikuara per rezervat e kapitalit te shoqerise.

**Kreu V**  
**Neni 21**  
**Viti Financiare**

Viti Financiare i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht , viti i pare financiare fillon nga data e rregjistrimit ne Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

**Neni 22**  
**Ekspertet**

Eksperti ka per detyre që te kontrollojetë gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise ,ate gjitheve jetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai ngarkohet nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiare vjetor si dhe ate per kontroollet periodike te ushtruara.

Këto raporte ai eshte i detyruar që këto raporte duhet t'ja paraqesë ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

**Kreu VI**  
**Prishja dhe njoftimet**

**Neni 23**  
**Prishja dhe likuidimi**

Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votave te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjithe ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vleresoje cdo pasuri dhe te percakroje rnenyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

**Neni 24**  
**Njoftimet**

- (1) Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin.
- (2) Shoqeria mund te njoftojte nje ortak personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim per gjigje ne adresen e regjistruar te ortakut ose ne adresen apo posten elektronike (nese ka) qe i eshte njoftuar shoqerise nga ortaku.

Kur ka disa bashkezoterues te nje kuote, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket ne perputhje me pikën 2 te nenin 72 te Ligjit.

**Neni 25**

**Riorganizimi I Shoqërisë bashkimi – ndarja**

Shoqëria mund të ndahet ,bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese se Ortakeve ,në përputhje me dispozitat ligjore te parashikuara në pjesen IX të Ligjit 9901 date 14.04.2012 “ Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ”

**Neni 26**

**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin në perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat ligjore te legislacionit Shqiptarë.

Per sa parashikohet në kete statut ,do te zbatohen dispozitat e Ligjit 9901 date 14.04.2012 “ Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ” ,Kodi Civil dhe cdo ligj tjeter specific ne R.Shqipërisë.

**Neni 27**

**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti si dhe per cdo mosmarreveshje që mund te linde mes shoqerise dhe te treteve do te jete kopetente Gjykata Shqiptare.

**Emrat dhe nenshkrimet e Ortakeve Themelues te Shoqerise "FARMACI 24 SHKODER " SHPK:**

1. Ditmir Saiti

